



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 2.

Prishtinë, më 26.12.2014, në orën 11:00.

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Valdete Bajrami, Slobodan Petroviq, Xhavit Haliti, Rustem Mustafa, Luljeta Veselaj - Gutaj, Vjosa Osmani, Arben Gashi, Ilir Deda dhe Blerim Shala.

Mungoi: Kujtim Paçaku.

Stafi mbështetës i Komisionit: Florent Mehmeti, Ahtere Loxha, dhe Safet Beqiri.

Mbledhjen e kryesoi: Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesja Teuta Sahatqija konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hap mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015;**

Kryetarja: paraqiti Projektligjin për Buxhetin e Kosovës për vitin 2015 dhe tregoi se ende nuk janë pranuar amendamentet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Ajo kërkoi që komisioni për këtë çështje të organizojë një mbledhje për ditën e hënë, me qëllim të shqyrtimit edhe të amendamenteve nga Komisioni funksional. Sahatqija tha se Projektligji për Buxhet ka kaluar me procedurë të përsheptuar në Kuvend, pra me shmangie të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe të gjithë ne, kemi pranuar një vendim

i cili e ngarkon Komisionin për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë këtë projektligj. Mirëpo, kjo nuk i ndalon që komisionet tjera ta shqyrtojnë projektligjin sipas fushëveprimtarisë së vet, në këtë rast duke ju referuar edhe nenit 57, pikës 1, të Rregullores së Kuvendit dhe e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ilir Deda: tha se shmangja e Rregullores është bërë që të përshpejtohen procedurat dhe jo të shkelen rregullat, përkatësisht neni 57, pika 1, që obligon katër komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë çdo projektligj, pra në këtë rast edhe Projektligjin për buxhetin. Gjithashtu ai bëri një krahasim me qershorin e vitit 2012, kur është bërë plotësimi dhe ndryshimi i Projektligji për buxhetin me procedurë të njëjtë dhe nuk janë anashkaluar këto katër komisione të përhershme. Deda sugjeroi që komisioni ti drejtohet Kryesisë së Kuvendi me një shkresë, që në raste të këtyre situatave në të ardhmen të ketë parasysh këto katër komisione të përhershme për shqyrtim.

Vjosa Osmani: u shpreh se pavarësisht vendimit, ne duhet të sillemi në pajtim me Rregulloren e punës dhe nenit që u referua në fillim. Komisioni mund ta shqyrtojë Projektligjin për buxhet dhe të hënën të ketë një takim për shqyrtimin e amendamenteve brenda fushëveprimtarisë së këtij komisioni lidhur me përputhshmërinë me Acquis të BE-së.

Kryetarja Teuta Sahatqija: më pas paraqiti raportin për këtë projektligj, i cili përcakton kornizën buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2015, me gjithsej 20 nene.

Legjislacioni i Bashkimit Evropian sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me buxhetin e shteteve anëtare, nuk përmban norma juridike për buxhetin kombëtar të shteteve anëtare, por kjo mbetet që të rregullohet me legjislacion të brendshëm të shteteve anëtare të BE-së, tha ajo duke shtuar se buxheti i Bashkimit Evropian rregullohet nga institucionet e saj në bazë të ndarjes së të drejtave dhe përgjegjësi.

Pas shqyrtimit të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, konstatoj se ky projektligj pasi që nuk është i rregulluar me legjislacionin primar dhe sekondar, përkatësisht të Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë parlamentare.

Dokumentet të cilat do të përcillen te anëtarët e komisionit ashtu siç ishin premtuar janë: Plan i punës për vitin 2014, Plan i Veprimit për MSA, Raporti i Progresit për vitin 2014, Plan i Veprimit për liberalizimin e vizave, Udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave dhe Strategjia Kombëtare për Integrim evropian.

Sahatqija shtoi se në këtë buxhet, Ministria e Integrimit Evropian nuk ka as një projekt, kurse buxheti i saj për vitin 2015 është paraparë të jetë 1.823.000 euro, me 85 punonjës, ku 682.000 euro janë për paga dhe mëditje. Ndërsa për vitin 2016 dhe 2017, parashihet që të ketë ulje të buxhetit. Pra, kjo tha se duhet të shqyrtohet dhe të ftohet ministri i Integrimit Evropian dhe të analizohet kjo çështje.

Vjosa Osmani: tha se duhet të shikohet nëse ky buxhet është në përputhje me Planin e Veprimit për MSA, pra edhe koston buxhetore të veprimeve në këtë plan. Ajo u shpreh se shumë prej këtyre kostove nuk janë paraparë në këtë buxhet, duke përmendur dy prej çështjeve, siç është administrata publike dhe mbrojtja e afërt për gjyqtaret, të cilat nuk janë të përfshira si kosto buxhetore në këtë buxhet. Po ashtu, ajo tha se ato duhet të thuhën në emër të komisionit në seancë, nëse është e pamundur që të bëhen në formë të rekomandimeve dhe jo vetëm të pajtohemi se kjo çështje nuk është e rregulluar me Acquis të BE-së, por të shikohet nëse ky buxhet është i harmonizuar edhe me dokumentet tjera, të cilat i ka miratuar Kuvendi.

Osmani potencoi çështjen e pavarësisë buxhetore të Kuvendit të Kosovës, i cili tha se duhet të ketë buxhetim të pavarur në përcaktimin e buxhetit të vet dhe si i tillë të

miratohet në qeveri, pa pësuar ndryshime dhe të procedohet pastaj për miratim në Kuvend. Kjo çështje është potencuar vazhdimisht në të kaluarën dhe është një nga rekomandimet kryesore të Komisionit Evropian, tha Osmani.

Ilir Deda: tha se ka dy çështje, një diskutim dhe një propozim. E para ka të bëjë me mospërputhshmërinë e projektligjit për buxhetin e vitit 2015, me vërejtjet e Raportit të Progresit, dhe potencoi vërejtjen si një ndër më kryesore se buxheti i Kosovës nuk po përpilohet në bazë strategjike, pa një plan të përbashkët zhvillimor të gjithmbarshëm. E dyta, tha ai, ka të bëjë me mungesën e rritjes së mjeteve për mekanizmat përgjegjës për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar për vitin 2015. Këto mjete mbeten të pa mjaftueshme që të përmbushen kërkesat e Bashkimit Evropian. Në arsim shtoi Deda, ka një ulje prej 3.8 %, për dallim të këtij viti që po përfundon, kurse standard është që vlera minimale të jetë 4 %. Ai tha se mungesa e planifikimit në zhvillim socio-ekonomik dhe destinomi i mjeteve në projekte infrastrukturore, e cila po ashtu është një nga kritikën e BE-së.

Propozoj që të ftohet ministri për Integrim Evropian në komision për tu njoftuar lidhur me gjendjen e migrimit të qytetarëve të Kosovës jashtë vendit, dhe shprehi rezervën e tij lidhur me formimin e task-forcave të ndryshme lidhur me këtë çështje.

3. Të ndryshme.

Kryetarja Teuta Sahatqija: tha se mbledhja e radhës e komisionit do të mbahet ditën e hënë në orën 8:30.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Znj. Teuta SAHATQIJA
